



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 122, datë 19.06.2024

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “FU-GEN” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.06.2024, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 886/18 prot, datë 14.06.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “FU-GEN” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “FU-GEN” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 886 prot., datë 04.04.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 62, datë 12.04.2024 vendosi të fillojë procedurën për licencim e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën 886/3 prot., datë 22.04.2024, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe i ka evidentuar informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet ende në aplikimin e saj.
- Gjithashtu me shkresën nr. 1030 prot., datë 02.05.2024, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbi fillimin e procedurës së licencimit të shoqërisë.
- Shoqëria me shkresën nr. 886/4 prot., datë 02.05.2024 ka përcjellë një pjesë të dokumentacionit të kërkuar.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 93, datë 13.05.2024, vendosi zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me aplikimin e shoqërisë “FU-GEN” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me qëllim zhvillimin e korrespondencës së mëtejshme apo dhe planifikimin e një seance dëgjimore për të sqaruar dokumentacionin që ka mbetur ende për t’u plotësuar dhe depozitimin e tij në vijim në ERE.
- Me shkresën nr. 886/6 prot., datë 22.05.2023 është njoftuar shoqëria për zhvillimin e një seance dëgjimore në lidhje me dokumentacionin e mbetur ende të pa plotësuar.
- Shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 886/7 prot., datë 27.05.2024 dhe nr. 886/8 prot., datë 29.05.2024, nr. 886/11 prot., 886/12 prot., datë 06.06.2024, 886/13 prot., datë 07.06.2024 dhe 886/15., datë 12.06.2024.
- Me vendimin nr. 114, datë 10.06.2024, bordi i ERE-s, vendosi zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me aplikimin e shoqërisë “FU-GEN” sh.p.k., për arsye të sqarimit/rakordimit të shumës së financimit në referencë të asaj që është përcaktuar nga kontrata më MIE-n dhe për të saktësuar afatin e fillimit të operimit duke qenë se data 01.06.2024 ka kaluar. Ky informacion/dokumentacion u depozitua nga shoqëria meshkresën e protokolluar në ERE me nr. 886/17 prot., datë 13.06.2024..
- Nga analiza e dokumentacionit në referencë të përcaktimeve të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit dhe ka plotësuar tërësisht dokumentacionin sa kërkuar në nenin 9, pika 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; pika 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”.
- Rezulton se shoqëria “FU-GEN” sh.p.k.:
 - Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë Kontratën nr. 2425 rep., nr. 1570 kol., datë 28.04.2023 “*Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier nga shoqëria “FU-GEN” sh.p.k.*”,
 - Ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit fotovoltaike me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së shoqërisë “OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES” sh.a. nr. 6357/3 prot., datë 28.06.2022;
Është pajisur me Vendim për VNM Paraprak, lëshuar më 10.06.2022 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për të zhvilluar projektin Ndërtimi i impiantit PV Fier”, me vendodhje në Topojë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier për fuqinë e instaluar 2 MW. Shoqëria ka dokumentuar fillimin e punimeve brenda afatit të vlefshmërisë së kësaj VNM-je.

- Centrali fotovoltaik parashikohet që të fillojë operimin në muajin shtator të vitit 2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “FU-GEN” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “FU-GEN” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES” sh.a. dhe shoqërinë “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti